

Që në bazë të nenit 36, 37.38. dhe 39 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 15/2016), nenit 32, paragrafi 1, pika 9 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e RS", Nr. 129/07), nenit 41 të Statutit të Komunës Medvegjës ("Gazeta Zyrtare e Qytetit të Leskovcit", numër 18/08 dhe 38/2012) dhe Vendimi për zbatimin e konkursit publik për emërimin e Drejtorit të Ndërmarrjes Publike "Obnova" Medvegjë, 06 numër 06-28/2018/11 nga data 19. qershor 2018 Kuvendi Komunal i Medvegjës në seancën e mbajtur më 19. qershor të vitit 2018. shpallë

SHPLLJE E KONKURSIT PUBLIK PËR EMËRIMIN E DREJTORIT NKP "OBNOVA" MEDVEGJË

I Të dhënat e ndërmarrjes publike:

Emri zyrtar "Ndërmarrja komunale publike "Obnova" Medvegja

Shkurtesa e ndërmarrjes NKP "Obnova" Medvegjë,

Selia 16240 Medvegjë, rruga Kej pa nr.

Numri personal 07360924, regjistruar në regjistrin e Agjensionit për regjistrat e ndërmarrsisë.

PIB 101464653

Kryesisht kodi i veprimtarisë është 36.00 – grumbullimi, pastrimi dhe distribuimi i ujit.

Menaxhimi dhe puna e Ndërmarrjes komunale publike "NKP Obnova" është rregulluar me vendimin mbi organizimin e konkursit publik komunal në Medvegjë (Gazeta Zyrtare e regjionit të Jugut së moravës nr .27/1989).

Menaxhimi dhe puna e Ndërmarrjes Publike "NKP Obnova" është rregullua me Vendimin për organizimin e ndërmarrjes komunale publike në Medvegjë (Gazeta Zyrtare e Rajonit të Jugut të moroves Nr.27 / 1989).

II Të dhënat mbi pozicionin e punës për të cilin shpallet lajmrimi për konkursin publik:

Drejtor i Ndërmarrjes komunale Publike "Obnova" Medvegjë, për periudhën e mandatit katërvjeçar, me vend pune në Medvegjë.

Drejtori i Ndërmarrjes Publike: paraqet dhe përfaqëson Ndërmarrjen publike, organizon dhe menaxhon procesin e punës, menaxhon punon e ndërmarrjes publike, propozon programin vjetor të biznesit dhe marrë masa për zbatimin e saj, propozon raportet financiare, kryen vendimet e këshillit mbikëqyrës dhe kryejnë detyra tjera të përcaktuara me ligj, me aktin themelues dhe me Statutin e ndërmarrjes publike.

III Kushtet për emërimin e drejtorit të ndërmarrjes publike:

Të drejtë për aplikimin kanë Të gjithë kandidatët e interesuar, të cilit përveç kushteve të përgjithshme të parashikuara nga dispozitat e Ligjit të Punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë" nr. 24/2005, 61/2005, 54/2009 dhe 32/2013),i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

1. që është i moshës ligjore dhe i aftë për punë
2. të ketë arsim të lartë në studimet themlore prej më së paku katër vjet gjegjesishtë në studimet akademike në vallim prej më së paku 240 SETP, studime akademike master, studimet Master profesionale, studimet akademike të spacializuara, apo studime të specializuara profesionale.
3. Të ketë më së paku 5 vite përvojë pune në vendet e punës për të cilat kërkohet arsim i lartë në përputhje me pikën 2.
4. Të ketë më së paku tri vite provoj pune në punët të cilat janë ndërlydhura me punët e ndërmarrjes publike,
5. njohja e fushës së menaxhimit korporativ,
6. të ketë përvojë pune në organizimin e punës dhe menaxhimin e biznesit,
7. që nuk është anëtar i asnjë partie politike, gjegjesishtë që nuk i është përcaktuar heshtja në ushtrimin e funksioneve në organin e partis politike,
8. që nuk është dënuar me burgim prej së paku gjashtë muajsh,
9. që nuk i është shqiptuar masa sigurimi në përputhje me ligjin që rregullon veprat penale, si:
 - trajtimi dhe kujdesi i detyrueshëm psikiatrik në institucion shëndetësor,
 - trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri,
 - trajtimi i detyrueshëm i personave të varur nga droga,
 - trajtimi i detyrueshëm i alkoolistëve,
 - Ndalimi i kryerjes së thirrjeve, aktiviteteve dhe detyrave.

IV Me kërkesën për aplikimin kandidati duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme: 1. Diploma mbi kryerjen e kualifikimit profesional; 2. Dëshmi për përvojën e punës më së paku 5 vite në profesion; 3. Çertifikata e lindjes; 4. Certifikata e Shtetësisë së Republikës së Serbisë; 5. Certifikata e aftësisë shëndetësore (dërgimi I mëvonshum, pas marrjes së vendimit për pranimin e kandidatëve); 6. Konfirmimi se kandidatët nuk janë dënuar për vepër penale më denim burgosje pa kushtë prej më së paku 6.Vërtetimi se kandidati nuk është dënuar për vepër penale me dënim të pakushtëzuar me burgim prej më së paku gjashtë muaj apo për vepër penale që e bën ata të paaftë për të kryer detyra në organ shtetëror (vërtetimin e lëshon Administrata e Policisë) 7. Vërtetimi që personi nuk është nënë hetime dhe se nuk ka qenë i akuzuar (vërtetimin e lëshon gjykata kompetente), 8. Biografi e shkurtër, 9. Fotokopja e vërtetuar e letërnjoftimit, 10. Deklarata e dhënë nën përgjegjësinë e plotë metariale dhe penale se ai nuk është anëtar i partive politike, gjegjesishtë se atij i është dhënë ndalesë në kryerjen e funksionit të tij në çështjet menaxhimit. Certifikata e Aftësive të Biznesit nga Qendra për Punë Sociale.

Dëshmia e përmbushjes së kushteve duhet të dorëzohet në mënyr origjinale ose fotokopje të vërtetuar.

V Adresa në të cilën dorzohet aplikimi në konkursin publik:

Komuna e Medvegjës, Rruga Jablanička 48, 16240 Medvegjë,

Komisioni për Emërimin e Drejtorit të Ndërmarrjeve Publike të komunës së Medvegjës, me shënimin "Për konkurs publik".

Aplikimet e Parakohshëme, pakuptueshëm dhe kërkesat që nuk përmbajnë të gjitha dëshmi të nevojshme, Komisioni hedh poshtë atë me konkluzion se kundër saj nuk është lejuar ankesa e veçantë.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 30 ditë nga data e publikimit të konkursit publik në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë".

VI Personi përgjegjës për dhënien e njoftimeve për konkursin publik për emërimin e drejtorit është Vladica Djokic, numri i telefonit 016 / 891-138.

Shënim: Konkursin publik zbaton Komisioni për emërimin e drejtorëve të ndërmarrjeve publike të komunës së Medvegjës, procedura zgjedhore mund të zbatohet në disa pjesë, me organizimin e interviste gojore me kandidatët ose në një mënyrë tjetër të përshtatshme, për të cilën Komisioni do t'i informojë kandidatët në kohën e duhur.

Shpallja e konkursit publik të publikohet në "Gazetën zyrtare të RS", më së paku në një gazet ditore e cila shpërndahet në të gjithë teritorin e Republikës së Serbisë dhe në faqën e internetit të komunës së Medvegjës.

06Numër:06-28/2018/12
Më 19 qershor 2018.
Medvegjë

KRYETARI,

Millan Stevanoviq, me dorë e vet

Shpallja shpallet në "Gazetën zyrtare të RS"
Numër 56/2018 prej 18.07.2018

SEKRETARI

Dragan Andrejeviq me dorën e vet